



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

RELACION

MBI MIRATIMIN PËR PJESËMARRJEN E BASHKISË BERAT ME PROJEKTIN ‘‘ MBROJTJA NGA ZJARRI NË SHQIPËRI DHE GREQI ( SHKURTIMI ‘FIRE PREP’) , PËR THIRRJEN IPA E TARGETUAR TË BASHKIMIT EUROPIAN , PROGRAMI INTERREG IV BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR SHQIPËRI- GREQI

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat në bashkëpunim me Korpusin Grek të Zjarrfikëseve (Greqi) , Ministrinë e Mbrojtjes në Shqipëri dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në Shqipëri, në kuadër të thirrjes IPA e targetuar e programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri- Greqi financuar nga Bashkimi Europian, kanë përgatitur projektin ‘‘ Mbrojtja nga zjarri në Shqipëri dhe Greqi’’ ( shkurtimisht ‘FIRE PREP’) .

Rezultatet e projektit për Bashkinë e Beratit, do të jenë si më poshtë:

- 1-Blerja e dy mjeteve zjarrfikëse për Bashkinë Berat për mbrojtjen nga zjarri në pyje.
- 2- Rikonstruksion i plotë dhe blerje pajisjesh për godinën e Stacionit të Zjarrfikëseve Berat.
- 3- Blerje uniformash për zjarrfikësit e Bashkisë Berat.
- 4-Pjesëmarrja në trajnime e zjarrfikësve të Bashkisë Berat.

Buxheti i Projektit për Bashkinë Berat do të jetë 840,520 euro. Kohëzgjatja e projektit do të jetë 30 muaj. Afati i fundit i aplikimit është data 24.02.2020.

Bashkëfinancimi i Bashkisë Berat do të jetë në masën 15% të buxhetit të Projektit dhe mbulimi i kostove të TVSH-së, kosto të cilat do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë për periudhën e zbatimit të Projektit Mars 2020- Shtator 2022. Bashkëfinancimi i Bashkisë është në shumën 271,207 euro, nga të cilat 126,078 euro mbulimi i koston 15% të buxhetit dhe 145,129 euro mbulim kosto TVSH.

Theksojmë se ky Projekt ka përfitueshmëri të lartë për Bashkinë Beratit për shkak të investimeve dhe aktiviteteve të parashikuara, duke realizuar disa komponentë shumë të rëndësishëm në përballimin e emergjencave civile dhe mbrojtjes nga zjarri.

Ju faleminderit,

KRYETAR I BASHKISË  
Ervin Demo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

PROJEKT-VENDIM

**MBI MIRATIMIN PËR PJESËMARRJEN E BASHKISË BERAT ME PROJEKTIN,  
“MBROJTJA NGA ZJARRI NË SHQIPËRI DHE GREQI ( SHKURTIMI ‘FIRE  
PREP” , PËR THIRRJEN IPA E TARGETUAR TË BASHKIMIT EUROPIAN ,  
PROGRAMI INTERREG IV BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR  
SHQIPËRI - GREQI**

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Integritimit Europian, mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 8, 9, 29, pika 2, 54, 64, gërma “c”,

**PROPOZON :**

1. Miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Berat, si Partner Lider me Projektin, “Mbrojtja nga zjarri në Shqipëri dhe Greqi ( shkurtimi ‘FIRE PREP’)", për thirrjen *IPA e targetuar* të Bashkimit Europian, Programi Interreg IV Bashkëpunimi Ndërkufitar Shqipëri- Greqi.
2. Bashkëfinancimi i Bashkisë Berat në këtë projekt është 271,207 euro, nga të cilat 126,078 euro mbulimi i kostos 15% të buxhetit dhe 145,129 euro mbulim kosto TVSH .
3. Me ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Integritimit Europian dhe Drejtoria e Financës.

KRYETARI BASHKISË

Ervin Demo



Ky projektvendim u pa dhe ka bazueshmëri ligjore.

Juriste  
Nertila Kadëna

Sekretare e Këshillit Bashkisë  
Bora Agalliu